



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti i Reformave dhe Integritimeve Evropiane

**Raport përmbledhës i projekteve të realizuara nga MAPL në
bashkëpunim me komuna gjatë vitit 2009**

Dhjetor 2009

FJALA HYRESE E MINISTRIT

Të nderuar lexues,

Kosova ka nevojë që të rris kapacitetet e saja në infrastrukturën publike. Në planin afatgjatë edhe procesi i reformës së pushtetit lokal garanton këtë. Natyrisht, procesi është kompleks dhe në këtë drejtim, komunat e Kosovës kanë nevojë për përkrahje që të rrisin kapacitetet inistucionale dhe teknike për të përmisuar kualitetin e shërbimeve për qytetarët.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuniteti i Donatorëve kanë dhënë një kontribut esencial në këtë drejtim dhe janë plotësisht të përkushtuar që këtë ndihmë ta vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme.

Raporti që keni në dorë, është vetëm një pjesë e investimeve publike komunale që ka bërë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2009.

Ne shpresojmë që edhe këto investime, do të shtojnë kapacitetet komunale përmes të cilit individët, organizatat dhe gjithë shoqëria mund të kenë, forcojnë dhe mirëmbajnë aftësitë e tyre për të përcaktuar dhe arritur objektivat e tyre zhvillimore përgjatë periudhës së ardhshme kohore, sepse qytetarët tanë kanë nevojë për shërbime më efikase.


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka përkrahur komunat me mjete buxhetore për të realizuar projekte të ndryshme të infrastrukturës publike dhe po ashtu ne tashmë jemi koordinatori kryesor për nivelin lokal për të orientuar në mënyrën e duhur dhe sipas prioritetve ndihmën e jashtme.

Nga ky raport Ju mund të vëreni se duke punuar bashkë me komunat ne kemi shtuar siperfaqet e parkingjeve dhe gjelbrimeve, kemi godina shëndetësore e shkollore të reja, kemi shtuar kilometrat e gypave të ujit e të rrjetit të kanalizimeve, kemi investuar në digjitalizimin dhe kompjuterizimin e punës në administratat lokale, kemi ndërtuar godina për stafin e administratës komunale dhe tani bilanci është shumë më mirë se vetëm 11 muaj më parë.

Në esencë, këto janë paratë Tuaja që ne po i përdorim, sepse këto investime janë paguar nga taksat e Juaja. Ne jemi përkujdesur që këto të shfrytëzohen me eficiencë dhe aty ku ka më së shumti nevojë.

Prandaj, shpresojmë që duke vazhduar për të punuar bashkarisht, do të rrisim këto kapacitete, për të krijuar një ambient të sigurtë e të prosperuar për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sadri Ferati
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal



Përmbajtja:

1. Përmbledhja ekzekutive	5
2. Koordinimi dhe Monitorimi i Projekteve	6
3. Raporti detaj për secilin prej 84 projekteve sipas regjioneve koordinuese	7
3.1 Komuna - Malishevë projekti "Ndërtimi i shk. fillore në fshatin Tërpezë"	7
3.2 Komuna - Pejë projekti "Ndërtimi i rrugës UÇK me 2 Korsi"	8
3.3 Komuna - Pejë projekti "Rregullimi i parkut Kalaja dhe Karagaj"	9
3.4 Komuna - Deçan projekti "Asfaltimi i rrugës në lagjen Gecaj në fshatin Llukë e ulët"	10
3.5 Komuna - Deçan projekti "Rekonstruimi i rrugës qendra e Deçanit- Carrabreg (faza e parë)"	11
3.6 Komuna - Deçan projekti "Asfaltimi i rrugës Irzniq-Kodrall-Pozhar-Llukë e Ulët"	12
3.7 Komuna - Suharekë projekti "Ndërtimi i trotuarit në rrugën Hajdin Berisha- Skenderbeu"	13
3.8 Komuna - Suharekë projekti "Ndërtimi i rrugës Mohlan- Krushicë"	14
3.9 Komuna - Suharekë projekti "Rregullimi i rrugës në fshatin Mushtisht"	15
3.10 Komuna - Suharekë projekti "Vazhdim i rrjetit të kanalizimit në fshatin Doberdolan"	16
3.11 Komuna - Suharekë projekti "Ndërtimi i rrugës Semetisht – Nishor – Faza e II"	17
3.12 Komuna - Istog projekti "Asfaltimi rrugës Suriganë -Cerkolez-Kujavq".	18
3.13 Komuna - Istog projekti "Ndërtimi i kanalizimit në Vrellë- Studenicë"	19
3.14 Komuna - Istog projekti "Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugës kopshti i fëmijëve – shkolla-Qendër në Gurakoc"	20
3.15 Komuna - Istog projekti "Asfaltimi i rrugës në qendrën urbane- Banjë"	21
3.16 Komuna - Fushë Kosovë projekti "Asfaltimi i rrugëve lokale në Fushë Kosovë".	22
3.17 Komuna - Junik projektit "Ndërtimi i Objektit të Administratës K. K Junik - Faza I"	23
3.18 Komuna - Zveçan projekti "Ndërtimi i rrjetit elektrik për lagjen Ukaj -Fshati Lipë"	24
3.19 Komuna - Shtime projekti "Ndërtimi i fazës së dytë të kanalizimit fekal dhe rehabilitimi i rrugës urbane në Shtime"	25
3.20 Komuna - Podujevë projekti "Asfaltimi i rrugës Dumnicë-Llaushë"	26
3.21 Komuna - Podujevë projekti "Asfaltimi i rrugës Letancë – Bajqinë"	27
3.22 Komuna - Prizren projekti "Asfaltimi i rrugës Jashar Salihu Prizren"	28
3.23 Komuna - Prizren projekti "Ndërtimi i zyrës së vendit në fshatin Zhur"	29
3.24 Komuna - Prizren projekti "Pajisje me inventar të qendrës së kulturës në Gjonaj"	30
3.25 Komuna - Prizren projekti "Rregullimi i miniparqeve Lakuriqi (1,2,3) në Prizren"	31
3.26 Komuna - Rahovec projekti "Kanalizimi fekal në fshatin Çifllak"	32
3.27 Komuna - Rahovec projekti "Meremetimi i ndërtesës së KK- Rahovec"	33
3.28 Komuna - Obiliq projekti "Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen e re në Milloshevë"	34
3.29 Komuna - Obiliq projekti "Ndërtimi i rrugës në fshatin Sibofc lagja Kelmendi"	35
3.30 Komuna - Obiliq projekti "Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Lulgjak"	36
3.31 Komuna - Obiliq projekti "Sistemi i ujësjellësit në fshatin Sibofc"	37
3.32 Komuna - Glllogoc projekti "Kanalizimi në Glllogar"	38
3.33 Komuna - Glllogoc projekti "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Nekovc"	39
3.34 Komuna - Glllogoc projekti "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Tërstënik"	40
3.35 Komuna - Lipjan projekti "Rrjeti i ujësjellësit në fshatin Livagjë Dobratinë dhe Konjuh"	41
3.36 Komuna - Prishtinë projekti "Asfaltimi i rrugës në Keqekollë lagja "Spahiu"	42
3.37 Komuna - Prishtinë projekti "Asfaltimi i rrugës Graçanicë-Llappllasellë"	43
3.38 Komuna - Prishtinë projekti "Kultivimi i gjelbërimit në lagjen Ulpiana"	44
3.39 Komuna - Prishtinë projekti "Rregullimi i terrenit sportiv në fshatin Hajvali"	45
3.40 Komuna - Shtërpçë projekti "Rregullimi i ngrohjes, dhe garazheve në ambulancën e mjekësisë familjare në Brod".	46
3.41 Komuna - Ferizaj projekti "Asfaltimi dhe rregullimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatrat Blinisht – Zaskok.	47
3.42 Komuna - Hani i Elezit projekti "Asfaltimi i rrugës Përroi i Rrezhancës".	48
3.43 Komuna - Shtërpçë projekti "Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Brod".	49
3.44 Komuna - Novo Bërdë projekti "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Tërniqec".	50
3.45 Komuna - Kaçanik projektit "Ndërtimi i katit të tretë në objektin KK Kaçanik"	51
3.46 Komuna - Viti projekti "Asfaltimi i rrugës Ramnishtë – Begunc".	52

3.47	Komuna - Shtërpçë projekti "Ndërtimi i objektit shëndetësor në fshatin Brod	53
3.48	Komuna - Mamushë projekti "Ndërtimi i murit mbrojtës përgjatë lumit Topllua"	54
3.49	Komuna - Novo Bërdë projekti "Asfaltimi i rrugës Sallkaj – Abazaj"	55
3.50	Komuna - Kamenicë projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Drenoc"	56
3.51	Komuna - Novobërdë projekti "Ndërtimi i fushës së sportit në sh.f. Minatori"	57
3.52	Komuna - Kamenicë projekti "Ndërtimi i shkollës dhe ambulancës në Hodec"	58
3.52	Komuna - Kamenicë projekti "Sistemi i Ujësjellësit në fshatin Drenoc"	59
3.53	Komuna - Mitrovicë projekti "Asfaltimi i rrugës Vllada Cvetkoviç në Kodrën e Minatorëve"	60
3.54	Komuna - Mitrovicë projekti "Asfaltimi i rrugës në mëhallën e Boshnjakeve"	61
3.55	Komuna - Dragash projekti "Ndërtimi QMF në fshatin Bresanë"	62
3.56	Komuna - Dragash projekti "Zyra e Vendit në fshatin Brod"	63
3.57	Komuna - Gjilan projekti "Rrjeti i pakompletuar i ujësjellësit në Kufc të Epërm"	64
3.58	Komuna - Gjilan projekti "Hapja dhe ndërtimi i rrugës Llabjan Parallo"	65
3.59	Komuna - Klinë projekti "Kanalizimi fekal në fshatin Gllarev"	66
3.60	Komuna - Klinë projekti "Meremetimi i pjesës së mbetur të objektit të Kryqit të Kuq"	67
3.61	Komuna - Leposaviq projekti "Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Koshtov-Bistricë dhe Ceraj"	68
3.62	Komuna - Gjilan projekti "Ndërtimi i gypit të ujësjellësit në rrugën Hasan Remniku"	69
3.63	Komuna - Gjilan projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Shillovë"	70
3.64	Komuna - Gjilan projekti "Ndërtimi i Zyrave të Vendit në Pasjak, Zhegër dhe Pogragjë"	71
3.65	Komuna - Gjilan projekti "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Makresh të Epërm"	72
3.66	Komuna - Gjilan projekti "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Partësh"	73
3.67	Komuna - Mitrovica projekti "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Kushtovë"	74
3.68	Komuna - Mitrovica projekti "Rehabilitimi i Shtëpive për rastet sociale në Kodrën e Minatorëve"	75
3.69	Komuna - Mitrovica projekti "Rehabilitimi i objekteve banesore i cili gjinden në rrugën Oslobogjenje në mëhallën e Boshnjakeve"	76
3.70	Komuna - Mitrovicë projekti "Ujësjellësi në fshatin Kodër"	77
3.71	Komuna - Mitrovicë projekti "Rregullimi i varrezave të qytetit"	78
3.72	Komuna - Mitrovicë projekti "Ndërtimi i sistemit të Ujësjellësit në fshatin Vaganicë"	79
3.73	Komuna - Skenderaj projekti "Ndërtimi i Objektit të Administratës Komunale"	80
3.74	Komuna - Gjilan projekti "Përfundimi i objektit të shtëpisë së kulturës në Stanishor"	81
3.75	Komuna - Vushtrri projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Maxhunaj lagjeja Qelaj"	82
3.76	Komuna - Vushtrri projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Druar lagjeja Gecaj"	83
3.77	Komuna - Vushtrri projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Mihaliq"	84
3.78	Komuna - Vushtrri projekti "Pajisje me mjetë të domosdoshme të punës për drejtorin komunale për mbrojtje dhe shpëtim dhe teknologji informative"	85
4.	Lista me Projektet e komunave të financuara nga MAPL për vitin 2009.....	86

1. Përmbledhja ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me misionin e saj në raport me komunat ka për qëllim Avancimin e Qeverisjes Lokale në Bashkëpunim me Institucionet tjera relevante, që konsiston në sigurimin e shërbimeve efikase në nivel komunal dhe sa më afër qytetarëve.

MAPL si çdo vit buxhetor ka përkrahur komunat me mjete kapitale për të realizuar projekte të ndryshme të infrastrukturës publike me qëllim të përmirësimit të kushteve të infrastrukturës për të gjithë qytetarët e Kosovës. MAPL tashmë është një prej koordinatorëve kyç për nivelin lokal për të orientuar edhe donacionet në nivelin e duhur dhe sipas prioriteteve.

Ky raport është i detajizuar dhe paraqet bashkëfinancimin e MAPL – së në shumë projekte të komunave, ka raste ku MAPL është financues i projektit në tërësi. Gjithsej MAPL në vitin 2009 ka realizuar 84 projekte në 36 komunat e Republikës së Kosovës, këto projekte janë të paraqitura në pjesën e parë të raportit ku janë të ndara në 4 grupe sipas regjioneve koordinuese.

2. Koordinimi dhe Monitorimi i Projekteve

Ministria e Administrimi të Pushtetit Lokal monitorimin dhe ecurinë e projekteve nëpër komunat e Republikës së Kosovës e ka realizuar duke i ndarë zyrtarët e Departamentit të Reformës dhe Integritimeve Evropiane në katër grupe punuese ku secili grup ka pasur në përgjegjësi monitorimin e projekteve. Katër grupet që kanë koordinuar dhe monitoruar projektet janë mbikëqyrur nga drejtori i DRIE-s z.Besim Kamberaj.

Grupi I ka qenë i përbërë prej: Fetije Begolli, Tushe Berisha, Besa Shala dhe Hanife Alimusaj, ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Fushë Kosovë, Zveçan, Suharekë, Malishevë, Deçan, Gjakovë, Istog, Pejë dhe Junik.

Grupi II ka qenë i përbërë prej: Vjollca Selimi, Emine Hoti dhe Fatmire Thaçi, ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Gllogoc, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Gracanica (Pilot), Prizeren dhe Rahovec.

Grupi III ka qenë i përbërë prej: Fatos Qerimi, Ramadan Potera dhe Sanije Dërguti, ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Mamushë, Shtërpç, Novo Berdë, Kaçanik, Kamenicë, Ferizaj, Viti dhe Hani Elezit.

Grupi IV ka qenë i përbërë prej: Drin Haraçia, Mehdi Retkoceri, Lumnije Azemi, Ymer Raci dhe Naim Zeqiri, ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Klinë, Dragash, Leposaviq, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok dhe Gjilan.

3. Raporti detaj për secilin prej 84 projekteve sipas regjioneve koordinuese

Komuna	Malishevë
Titulli i projektit	Ndërtimi i shk. fillore në fshatin Tërpezë
Përshkrimi i Projektit	Projekti - Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Tërpezë është dizajnuar në mënyrë që të krijoj kushte më të volitshme për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor të shkollës fillore. Fshati ka 175 shtëpi banimi dhe 1068 banore. Me projekt është paraparë që objekti të përfshijë një sipërfaqe prej 500m², ndërsa përmban 4 dhoma mësimi, sallën e arsimitarëve dhe lokalet tjera përcjellëse.
Outputet / Përfitimet	Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor të 257 nxënësve të shkollës fillore , si dhe edukim i brezit të ri.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	17.04.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	139,883.61 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	24.04.2009.
Vlera e Kontraktuar	339 726,94 €
Emri i Kontraktuesit	NNP" ARBERI"-Malishevë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	139,883.61 €

Fotot :



Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Tërpezë

Komuna	Pejë
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës "UÇK" me 2 Korsi.
Përshkrimi i Projektit	Projekti ndihmon zhvillim të mirë socio- ekonomik të qytetarëve dhe gjithashtu ofron siguri më të madhe në të gjitha fushat e jetës, e më së shumti do t'u ofroj një komoditet ngasësve të veturave dhe këmbësorëve. Projekti përfshinë trasimin, ngjeshjen, shtresat paraprake dhe asfaltimi i rrugës me 2 korsi sipas projektit standardeve të nevojshme.
Outputet / Përfitimet	Mirëqenie sociale , ndikim në zhvillim ekonomik, qarkullim normal i automjeteve dhe këmbësoreve etj.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	17.03.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	450 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	12.08.2009.
Vlera e Kontraktuar	1.469.428,00 €
Emri i Kontraktuesit	Engineering grup-Arton Dodaj.
Pagesat	
Vlerat e pagesës	450 000,00 €

Fotot :



Ndërtimi i rrugës "UÇK" me 2 Korsi.

Komuna	Pejë
Titulli i projektit	Rregullimi i parkut Kalaja dhe Karagaq.
Përshkrimi i Projektit	Në parkun Karagaq është paraparë rregullimi i rrugëve – kubëzimi i këtyre rrugëve, vendosja e anësorëve, vendosja e dheut dhe hedhja e farës së barit. Po ashtu në parkun e Karagaqit do të shtrohen shtigjet me zhavorr, dhe do të bëhet kubëzimi i hapësirës dhe rregullimi i liqenit artificial.
Outputet/ Përfitimet	Krijimi i hapësirave rekreative.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	23.08.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	100 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	27.05.2009
Vlera e Kontraktuar	99,075.60 €
Emri i Kontraktuesit	
Pagesat	
Vlerat e pagesës	99,075.00 €


Fotot :



Rregullimi i parkut Kalaja dhe Karagaq.

Komuna	Deçan
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës në lagjen Gecaj në fshatin Llukë e ulët.
Përshkrimi i Projektit	Ndër prioritetet kryesore për zhvillim të infrastrukturës rrugore komunale është edhe projekti "Asfaltimi i rrugës në lagjen e Gecajve në fshatin Llukë e Ulet" në gjatësi L-490 m dhe B-3,5-4,5 m. Kjo rrugë ka rëndësi të madhe në zhvillimin e jetës normale për shumë banorë të kësaj ane e sidomos për njerëzit të cilët do të vizitonin Kullën e Gecajve e cila është pjesë shumë rëndësishme e trashëgimisë kulturore.
Outputet / Përfitimet	Zhvillim ekonomik, qarkullim normal i automjeteve dhe këmbësoreve
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	25.09.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	49 983,00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	27.10.2009
Vlera e Kontraktuar	39 876,20€
Emri i Kontraktuesit	
Pagesat	
Vlerat e pagesës	39 876,20€

Fotot :



Asfaltimi i rrugës në lagjen Gecaj në fshatin Llukë e ulët.

Komuna	Deçan
Titulli i projektit	Rekonstruimi i rrugës qendra e Deçanit- Carrabreg (faza e parë)
Përshkrimi i Projektit	Asfaltimi i rrugës është bërë në gjerësi sa të kalojnë dy automjete në të njëjtën kohë në drejtime të ndryshme të mos pengojnë njëra tjetrën dhe do të jetë një rrugë transite e qytetit, do të mundësoj qarkullimin e lirë dhe më të mirë të qytetarëve.
Outputet / Përfitimet	Kanë përfituar 2000 banorët e fshatit Carrabreg dhe K.K Deçan.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	02.02.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	100,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	K.K. Deqan
Data e nënshkrimit të kontratës	30.04.2009
Vlera e Kontraktuar	283.803.18 €
Emri i Kontraktonit	“ Lika Trade” Sh.P.K.Deqan
Pagesat	
Vlerat e pagesës	100,000.00€

Fotot :



Rekonstruimi i rrugës qendra e Deçanit- Carrabreg (faza e parë)

Komuna	Deçan
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës Irzniq-Kodralli-Pozhar-Llukë e Ulët
Përshkrimi i Projektit	Ndër prioritetet kryesore për zhvillim të infrastrukturës rrugore komunale ishte edhe projekti “Asfaltimi i rrugës Irzniq-Kodralli-Pozhar-Llukë e Ulët “ Asfaltimi i kësaj rruge është bërë në gjerësi sa të kalojnë dy automjete në të njëjtën kohë në drejtime të ndryshme të mos pengojnë njëra tjetrën dhe do të jetë një rrugë transite e qytetit, do të mundësoj qarkullimin e lirë dhe më të mirë të qytetarëve
Outputet / Përfitimet	Shkurtimi i rrugës në magjistralen Pejë deri afër Gjakovës që lidh shumë fshatra, ku qarkullimi i qytetarëve dhe mallrave do të jetë më i lehtë.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	17.03.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	120,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	K.K.Deqan
Data e nënshkrimit të kontratës	30.04.2009
Vlera e Kontraktuar	277.744.00 €
Emri i Kontraktorit	“ Lika Trade” Sh.P.K.Deqan
Pagesat	
Vlerat e pagesës	120,000.00€

Fotot :



Asfaltimi i rrugës Irzniq-Kodralli-Pozhar-Llukë e Ulët

Komuna	Suharekë
Titulli i projektit	<i>Ndërtimi i trotuarit ne rrugën "Hajdin Berisha-Skenderbeu"</i>
Përshkrimi i Projektit	Realizimi i këtij projekti ishte prioritet i Komunës ku me përfundimin e këtij projekti iu ka mundësuar banorëve qarkullim më të mirë. Ne këtë rrugë është bërë ndërtimi i trotuarit me kubëza betoni në trashësi prej 8 cm, mbi rëre (5 cm) sipas projektit detal dhe standardeve të ndërtimit.
Outputet / Përfitimet	Me realizimin e këtij projekti kanë përfituar qytetarët e këtij lokacioni të cilëve ju ka mundësuar qarkullim me i lehtë.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	22.09.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	102 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	27.10.2009.
Vlera e Kontraktuar	102,000.00€
Emri i Kontraktuesit	"Bamirësi" Suharekë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	102,000.00€

Fotot :



Ndërtimi i trotuarit ne rrugën "Hajdin Berisha- Skenderbeu"

Komuna	Suhareka
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës Mohlan- Krushicë
Përshkrimi i Projektit	Realizimi i këtij projekti krijon kushte për investime të mëtejme në fushën e blegtorisë dhe bujqësisë etj. Ndërtimi i rrugës lidhë 3 fshatra dhe është në gjatësi prej 3360 m. Po ashtu është paraparë të ndërtohet sistemi i largimit të ujërave atmosferike zgjerim për prankalim të autobusëve, bankinat.
Outputet / Përfitimet	Me përfundimin e këtij projekti kanë përfituar fshatrat Llanisht, Papaz, Budakove nëpër të cilën qarkullojnë afër 841 banorë dhe 487 nxënës.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.04.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	150 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	22.07.2009.
Vlera e Kontraktuar	335 834,82 €
Emri i Kontraktuesit	“Emona” Suhareke
Pagesat	
Vlerat e pagesës	149,999.97 €

Fotot :



Ndërtimi i rrugës Mohlan- Krushicë

Komuna	Suhareka
Titulli i projektit	Rregullimi i rrugës në fshatin Mushtisht
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt fillon nga qendra dhe vazhdon për në lagjen nr. 1 dhe do të ketë gjatësinë prej 2000m me gjerësi 5.5 m, realizimi i kanalizimit të ujërave atmosferik me elemente përcjellëse, si dhe finalizimi i tyre sipas standardeve. Kjo rrugë lidhet me rrugën Suharekë - Shtërpçë
Outputet / Përfitimet	Me përfundimin e këtij projekti kanë përfituar afër 2000 banor të lagjes nr .1 ndërsa i tërë fshati ka 5700 banorë.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	16.04.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	50 000.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	23.06.2009
Vlera e Kontraktuar	131 829,22 €
Emri i Kontraktuesit	NNP “NBT ING”
Pagesat	
Vlerat e pagesës	50 000,00€

Fotot :



Rregullimi i rrugës në fshatin Mushtisht

Komuna	Suhareka
Titulli i projektit	Vazhdim i rrjetit të kanalizimit në fshatin Doberdolan
Përshkrimi i Projektit	Realizmi i këtij projekti do të bëhet me qëllim të parandalimit të epidemive të ndryshme, kështu që ky projekt përfshinë derdhjen e ujërave në gropën septike aktuale të fshatit Dobërdolan e cila gropë duhet të eliminohet, dhe vazhdimi i këtij rrjeti deri të kycja në rrjetin e kanalizimit ekzistues të fshatit Studenqan. Gjatësia e kanalizimit është 1000 m.
Outputet / Përfitimet	Përfitues të drejtpërdrejt do të jenë banorët e fshatrave Dobërdolan dhe Studenqan me gjithsej 6580 banore.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	16.04.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	34 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	27.10.2009.
Vlera e Kontraktuar	74.361,80 €
Emri i Kontraktuesit	"SMAKA"
Pagesat	
Vlerat e pagesës	33,999.99 €


Fotot :



Vazhdim i rrjetit të kanalizimit në fshatin Doberdolan

Komuna	Suharekë
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës Semetisht – Nishor – Faza e II
Përshkrimi i Projektit	Një ndër prioritetet e KK Suharekë ishte edhe vazhdimi i projektit për ndërtimin rrugës Semetisht –Nishor. Ky projekt do të përfshijë ndërtimin e rrugës me gjatësi 4 km dhe gjerësi 5.5 m në drejtim të Semetisht- Nishor – Kravasari sipas standardeve.
Outputet / Përfitimet	Me përfundimin e këtij projekti kanë përfituar banorët e fshatrave Semetisht –Nishor –Kravasari me mbi 4000 banor, nxënësit e shkollave fillore “Hasan Prishtina” dhe “Bajram Curri” me gjithsej 634 nxënës si dhe qytetarë të tjerë.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	16.04.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	166 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	08.06.2009.
Vlera e Kontraktuar	193.932,69 €
Emri i Kontraktuesit	“GASHI ING”
Pagesat	
Vlerat e pagesës	166 000,00 €

Fotot :



Ndërtimi i rrugës Semetisht – Nishor – Faza e II

Komuna	Istog
Titulli i projektit	Asfaltimi rrugës Suriganë -Cerkolez-Kujavq.
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt përfshin asfaltimin e rrugës me gjatësi prej 3960m., e cila ka rëndësi shumë dimensionale në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Punët që janë përfshi në këtë projekt janë ngjeshja e trasesë, gërmimi dhe largimi i materialit mbushja me zhavorr natyral, punimi i tamponit dhe shtresës së asfaltit, vendosja e gypave dhe hapja e kanaleve anësore.
Outputet / Përfitimet	Me këtë rrugë përfitojnë tre fshatra e cila mundëson ndaljen e emigrimit fshat –qytet etj.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	07.08.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes se Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	310.000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	02.10.2009
Vlera e Kontraktuar	329.169.00 €
Emri i Kontraktonit	Graniti -Istog
Pagesat	
Vlerat e pagesës	310,000.00 €

Fotot :



Asfaltimi rrugës Suriganë -Cerkolez-Kujavq.

Komuna	Istog
Titulli i projektit	Ndërtimi i kanalizimit në Vrellë- Studenicë
Përshkrimi i Projektit	Vrella është një ndër fshatrat më të mëdha të komunës së Istogut me mbi 4300 banor e cila shtrihet afër bjeshkëve të thata. Ky lokalitet që moti është ballafaquar me problemin e ndërtimit të kanalizimit të ujërave të zeza.
Outputet / Përfitimet	Në këtë kanalizim kyçen 900 shtëpi (familje) me 4300 banorë me ç'rast përmirësohet standardi jetësor, zvogëlohet shpërngulja fshatë- qytet dhe evitohet rreziku i sëmundjeve të ndryshme epidemiologjike.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	10.03.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	367 130,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	16.07.2009.
Vlera e Kontraktuar	367 130,00 €
Emri i Kontraktonit	SHA Berisha Kompani
Pagesat	
Vlerat e pagesës	367 130,00 €


Fotot :



Ndërtimi i kanalizimit në Vrellë- Studenicë

Komuna	Istog
Titulli i projektit	Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugës kopshti i fëmijëve - shkolla-Qendër në Gurakoc.
Përshkrimi i Projektit	Qendra urbane e Gurakocit shtrihet në pjesën qendrore të territorit të komunës së Istogut me një popullsi prej 4355 banorë. Projekti përfshin asfaltimin e rrugës në gjatësi prej 1200 m si dhe kubëzimi i trotuareve .
Outputët / Përfitimet	Me këtë rrugë dhe trotuare përfitojnë më se 4400 banorë të kësaj qendre, lëvizja e lirë dhe evitimi i aksidenteve të komunikacionit si dhe do të ndikon në zhvillimin ekonomik.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.04.2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	100,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	29.06.2009
Vlera e Kontraktuar	99.279,00 €
Emri i Kontraktonit	NNSH "Themeli"
Pagesat	
Vlerat e pagesës	99.279,00 €

Fotot :



Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugës kopshti i fëmijëve -shkolla-Qendër ne Gurakoc

Komuna	Istog
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës në qendrën urbane- Banjë
Përshkrimi i Projektit	Qendra urbane e Banjës shtrihet në pjesën perëndimore të territorit të komunës së Istogut me një komunitet të përzier dhe popullatë mbi 2000 banorë. Projekti përfshinë asfaltimin e rrugës me gjatësi 1200m. Ky projekt përfshin fazën e tretë të ndërtimit
Outputet / Përfitimet	Ky projekt ndikon në zhvillim ekonomik, lehtësimin e qarkullimit të përgjithshëm në trafik.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.04. 2009.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	/
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	100 000,00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	01.07.2009
Vlera e Kontraktuar	114.250,00
Emri i Kontraktuesit	Sh.p.k "Granit" Istog
Pagesat	
Vlerat e pagesës	100,000.00 €

Fotot :



Asfaltimi i rrugës në qendrën urbane- Banjë

Komuna	Fushë Kosovë
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugëve lokale në Fushë Kosovë.
Përshkrimi i Projektit	Komuna e Fushë Kosovës ka mbi 30,000 banor, sipërfaqe rreth 100 km ² , është pikë lidhëse në mes Prishtinës dhe Aeroportit ku edhe autostrada kalon nëpër qytezën e Fushë Kosovës. Janë asfaltuar 25 rrugica lokale. Banorët e këtyre lagjeve janë përball me probleme të shumta për shkak të rrugës së pa asfaltuar.
Outputët / Përfitimet	Me përfundimin e këtij projekti kanë përfituar qytetarët e këtyre lagjeve.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	28.01.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	350,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL
Data e nënshkrimit të kontratës	20.05.2009
Vlera e Kontraktuar	349.942.55 €
Emri i Kontraktonit	Burimi,sh,p,k,Doganaj-Kaçanik
Pagesat	
Vlerat e pagesës	349.942.55 €

Fotot :



Asfaltimi i rrugëve lokale në Fushë Kosovë.

Komuna	Junik
Titulli i projektit	Ndërtimi i Objektit të Administratës K. K Junik - Faza I
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimi i objektit të administratës – faza e parë , ku përfshihen punimet e vrazhda (deri në kulm) , themelet, pllakat mbi themele , mbi përdhes, kati i parë dhe kati i dytë, mbulesa (kulmi), muratimi i mureve të jashtme dhe të brendshme duke e përfshirë edhe ujësjellësin , kanalizimin dhe elektriken - rrjetin primarë.
Outputët / Përfitimet	Përfundimin i këtij projekti do të ndikoj në rezultatet e punës duke u bazuar në kushtet më të mira të ambientit punues.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	18.05.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	300,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL
Data e nënshkrimit të kontratës	05.10.2009
Vlera e Kontraktuar	268,819.47 €
Emri i Kontraktonit	N.N.T“ Albes “ Istog
Pagesat	
Vlerat e pagesës	161,291.67€

Fotot :



Ndërtimi i Objektit të Administratës K. K Junik - Faza I

Komuna	Zveçan
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrjetit elektrik për lagjen Ukaj -Fshati Lipë
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimi i rrjetit elektrik për lagjen Ukaj fshati Lipë,për furnizim normal me energji elektrike dhe kushte elementare për jetë është ndërtuar rrjeti i ri i linjës së re të tensionit të lartë dhe tensionit të ulët përbrenda lagjes si dhe vendosja e një trafostacioni në këtë lagje.
Outputet / Përfitimet	Me përfundimin e këtij projekti banorët e fshatit Lipë do të kenë furnizimin më të rregullt të energjisë elektrike
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	12.06.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	75,000.00€
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	14.10.2009
Vlera e Kontraktuar	74.888.00 €
Emri i Kontraktonit	Everyday
Pagesat	
Vlerat e pagesës	74.888.00 €

Fotot :



Ndërtimi i rrjetit elektrik për lagjen Ukaj -Fshati Lipë

Komuna	Shtime
Titulli i projektit	Ndërtimi i fazës së dytë të kanalizimit fekale dhe rehabilitimi i rrugës urbane në Shtime
Përshkrimi i Projektit	Qyteti i Shtimes numëron rreth 12,000 mijë banorë me 1,645 shtëpi banimi, 461 lokale afaristë, 3 shkolla, 1 ambulancë, entin special si dhe disa objekte shoqërore. Falë kryqit të kuq Gjerman prej vitit 2002 u zgjidh problemi shumë i madh i ujit të pijshëm, por si pasojë e mungesës së kanalizimit qendror fekal prej vitit 1994-1996 janë paraqitur 149 të sëmur nga epidemia e tifos abdominale. Shkaku që u paraqit kjo epidemi ishte pikërisht mungesa e kanalizimit adekuat fekal si dhe mungesa e atëhershme e ujësjellësi. Realizimi i këtij projekti mundëson një ambient më të shëndosh dhe më të mirë për banorët e kësaj anë.
Outputet / Përfitimet	Përmirësimi i shërbimeve komunale, trajtimi adekuat i ujërave të zeza, parandalimi për përhapjen e epidemive të ndryshme, ambient më të pastër dhe më të shëndosh, do të krijohen parakushte për rregullimin e infrastrukturës së gjithëmbarshe të qytetit si dhe qarkullimi më i lehtë për automjete.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	10.03.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	450,000.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	13.05.2009
Vlera e Kontraktuar	499,957.09
Emri i Kontraktonit	NPTSH "Getoari" - Prizren
Pagesat	
Vlerat e pagesës	450,000.00€

Fotot :



Ndërtimi i fazës së dytë të kanalizimit fekale dhe rehabilitimi i rrugës urbane në Shtime

Komuna	Podujevë
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës Dumnicë-Llaushë
Përshkrimi i Projektit	Rruga ka qenë e pa asfaltuar dhe e shkatërruar, si dhe me plot me gropa, ku ka penguar qarkullimin e lire të qytetarëve dhe në mungesë të kësaj nuk ka pasur perspektiv për zhvillim ekonomik, e as zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë. Popullata vazhdimisht është shpërngulur nga këto treva pasi që kanë munguar kushtet për një jetë normale. Rruga është e gjatë 5353m, e gjerë 5m, trashësia e asfaltit me një shtresë d=7cm, gjendet në zonën kufitare me Serbinë .
Outputet/ Përfitimet	Qarkullimin e lirë të qytetarëve , zhvillimin e bizneseve privatë, punësimin e femrës në të dy sektorët, rregullimin e ambientit e në shumë lëmi tjera si dhe ndihmon në bashkëpunimin ndërkufitar.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	10.03.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	13.11.2009
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	479,878.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	02.06.2009
Vlera e Kontraktuar	553,334.21
Emri i Kontraktonit	„Toifor” shpk, Prishtinë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	479,878.00€

Fotot :



Asfaltimi i rrugës Dumnicë – Llaushë

Komuna	Podujevë
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës Letancë – Bajqinë
Përshkrimi i Projektit	Nëpër këtë rrugë frekuentojnë banorët e fshatit Bajqinë, Letanc, Doberdol, Zakut numri i të cilave është më tepër se 6.000 banor. Por nëpër këtë rrugë qarkullojnë edhe shumë banorë të fshatrave tjera që gjinden rreth fshatrave të cekura më lartë pasi që kjo rrugë e shkurton rrugën për në Podujevë. Fshatrat Letanc dhe Bajqinë gjinden në veri të Podujevës. Fshati Letanc është në pjesën veriore të Podujevës kurse në anën veriperëndimore lidhet me këtë rrugë me fshatin Bajqinë. Në mungesë të kësaj rruge banorëve të kësaj ane shpesh ju ka vështirësuar udhëtimi deri në Podujevë.
Outputët / Përfitimet	Rruga lidhë rrugën e asfaltuar Podujevë-Kërpimëh me fshatin Letanc dhe Podujevë për disa kilometra do të jetë më e shkurt. Do të behët zgjerimi i rrugës dhe qarkullimi i qytetarëve dhe nxënësve do të jetë shumë me i lirshëm.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.04.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	246,000.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	17.09.2009
Vlera e Kontraktuar	397,873.46
Emri i Kontraktonit	„Toifor” shpk, Prishtinë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	123,000.00€

Fotot :



Asfaltimi i rrugës Letancë – Bajqinë

Komuna	Prizren
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës „Jashar Salihu” Prizren
Përshkrimi i Projektit	Gjendja aktuale e kësaj rruge ka qenë jo e mirë, kanë qenë evidente gropa të mëdha që kanë pamundësuar qarkullimin e lirë të automjeteve dhe banorëve të kësaj pjese. Vështirësi në qarkullim e banorëve të kësaj pjese ka pasur sidomos gjatë dimrit. Realizimi i këtij projekti ka përmirësuar kushtet e transportit për automjetet dhe qarkullimit të kalimtarëve në rrugë.
Outputet / Përfitimet	Rezultat i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës rrugore, përmirësimi i kushteve jetësore dhe lëvizja e lirë e qytetarëve në këtë lokalitet.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	28.09.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	40,000.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	04.11.2009
Vlera e Kontraktuar	70,818.68
Emri i Kontraktorit	NNp,, Renelual Tahir”
Pagesat	
Vlerat e pagesës	40,000.00

Fotot :



Asfaltimi i rrugës „Jashar Salihu” Prizren

Komuna	Prizren
Titulli i projektit	Ndërtimi i zyrës së vendit në fshatin Zhur
Përshkrimi i Projektit	Në Republikën e Kosovës vendbanimet janë të shpërndara dhe larg qendrave komunale dhe institucioneve tjera, andaj ka qenë e nevojshme që shërbimet komunale të jenë më afër qytetarëve për arsye se qytetarët mos të udhëtojnë deri në zyrat komunale në qytetet më të mëdha për të përfituar nga shërbimet komunale. Qytetarëve iu është dashtë të paguajnë shpenzimet e udhëtimit deri në zyret më të afërta komunale.
Outputët / Përfitimet	Me përfundimin e projektit ofrohen shërbimeve më afër për qytetarëve.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	16.06.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	35,000.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL
Data e nënshkrimit të kontratës	08.10.2009
Vlera e Kontraktuar	33,553.23
Emri i Kontraktonit	N.P.N. „Pro-Ark”
Pagesat	
Vlerat e pagesës	13,421.29 €

Fotot :



Ndërtimi i zyrës së vendit në fshatin Zhur

Komuna	Prizren
Titulli i projektit	Pajisje me inventar të qendrës së kulturës në Gjonaj
Përshkrimi i Projektit	Qendra e kulturës në Gjonaj mbulon nevojat e Regjionit të Hasit me rreth 20.000 banorë, është në qendër të fshatit Gjonaj, aty ku zhvillohen shumë aktivitete jo vetëm kulturore por në këtë qendër funksionon OJQ “Iniciativa Rinore”, SHKA “Malësori” që është shumë aktive dhe në çdo vit organizohet Festivalin Folklorik “Hasi Jehon” ngjarje që ka kaluar kufijtë e Kosovës. Gjithashtu funksionon Biblioteka e pranuar nga MKRS e Qeverisë së Kosovës, në këtë qendër organizohen kurse të gjuhës angleze dhe të kompjuterëve pasi që me donacionin e Fondacionit SOROS funksionon edhe kabineti i kompjuterëve.
Outputët / Përfitimet	Me ndërtimin e kësaj Qendre jeta në Has është bërë më atraktive, më tërheqëse sidomos për të rinjtë .
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes se Mirëkuptimit	27.03.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	75,450.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	23.06.2009
Vlera e Kontraktuar	72,599.00
Emri i Kontraktonit	N.T. „Kosovatregu” Prizren
Pagesat	
Vlerat e pagesës	72,599.00€

Fotot :



Pajisje me inventar të qendrës së kulturës në Gjonaj

Komuna	Prizren
Titulli i projektit	Rregullimi i miniparqeve Lakuriqi (1,2,3) në Prizren
Përshkrimi i Projektit	Qyteti i Prizrenit ka mbi 220,000.00 banor ku ka nevojë për krijimin e miniparqeve dhe hapësirave tjera rekreative për qytetarët, ku dihet ndërtimet e mëparshme pa planifikim kanë bërë që qyteti të mos ketë sipërfaqe të mëdha gjelbëruese dhe rregullim të infrastrukturës ambientale. Këtu është bërë mbjellja e barit, vendosja e ulëseve, ndriçimi etj.
Outputët / Përfitime	Krijimi i vendeve rekreative për qytetarët.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	14.01.2009
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	100,000.00
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	05.06.2009
Vlera e Kontraktuar	85,403.55
Emri i Kontraktonit	OE-NSH "Shërbimi" -Prizren
Pagesat	
Vlerat e pagesës	85,403.45€

Fotot :



Rregullimi i miniparqeve Lakuriqi (1,2,3) në Prizren

Komuna	Rahoveci
Titulli i projektit	Kanalizimi fekal në fshatin Çifllak
